

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali në tenderin e KQZ: Si ndërhyri Sekretarja në sistem për favorizuar kompaninë e vëllain e Ferit Hoxhës që hetohet në dosjen e AKSHI-t
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/skandali-ne-tenderin-e-kqz-si-nderhyri-sekretarja-ne-sistem-per-favor-i514877
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:58:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:42:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a760d527bc5a714f9a53d1bb351d3fb35d3aaad1bb79677fe402d1aed6c7bb5d
TEKSTI	a8b1407c2b23f2208c7cd25bc4f1e6adeae47a1862dda5903c4f81518d015e44
PAMJA	027f1a4166f5bd65b741f626f8f7d91c520e268196f1bfe46109f4e0c2cbc76f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0ba02f551e1581246621c807e1f8736b0e33ee16447589663ab2894543daaa72
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0ba02f551e1581246621c807e1f8736b0e33ee16447589663ab2894543daaa72

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tipi i Kontratës: Sherbime.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedure e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, elektronike.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-52084-06-23-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mirëmbajtja e moduleve ekzistuese të KQZ-së.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 24.06.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 33 datë 30 Qershor 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në qendër të kësaj historie nuk është më thjesht skualifikimi i rivalëve, por një pyetje mjaft më e rëndë, kush futi duart në sistemin elektronik të prokurimeve?

Gjurmët digjitale të zbulura nga Komisioni i Prokurimit Publik nuk lënë hapësirë për alibi. Ato çojnë te emri i Jona Josifit, në atë kohë Sekretare e Përgjithshme e komanduar e KQZ-së, një zyrtarë që ligjërisht nuk kishte asnjë tagër apo lidhje me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave që përzgjedhi fituesin.

eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) Komisioni konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe konkretisht znj.

4

Daniela Alimemeti, z. Redion Lila dhe znj. Fatjona Sulaj, të cilët kanë rivlerësuar me pikë përkatësisht ofertën e operatorit ekonomik ofertues "INSTANT.AL" SHPK, ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK" dhe ofertën e operatorit ekonomik "Evolve Web Studio" SHPK sipas vlerësimit të bërë nga po ky komision në datën 16.12.2025, referuar shkresës nr. 48/4 prot, datë 26.01.2026 "Përcjellje vendimi të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave" protokolluar me tonën me numër protokoll nr. 107/3 prot, datë 27.01.2026, ndërkohë që konstatohet se ofertat e sipërpërmendura janë rivlerësuar edhe nga një person tjetër pranë autoritetit kontraktor me username "Jonakqz Josiff" (e cila nuk është anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave), e cila ka rivlerësuar më 0 (zero) pikë çmimin e ofertës dhe propozimin teknik të operatorit ekonomik ofertues "INSTANT.AL" SHPK dhe operatorit ekonomik "Evolve Web Studio" SHPK, ndërsa oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK" është rivlerësuar me pikët maksimale për 5 (pesë) kriteret e përzgjedhjes së ofetës fituese të përcaktuara në pikën 4.4 "Kriteret e përzgjedhjes së fituesit" të Seksionit 4 "Procedura" të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit të rivlerësuar. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se, për rivlerësimin me pikë të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK", autoriteti kontraktor duhet të lexojë me vëmendje interpretimet e Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin Nr. 227/2026, datë 10.02.2026, duke ju referuar bazën ligjore, duke ju referuar vlerësimit me pikë të bërë nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në datën 16.12.2025, referuar shkresës nr. 48/4 prot, datë 26.01.2026 "Përcjellje vendimi të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave" protokolluar me tonën me numër protokoll nr. 107/3 prot, datë 27.01.2026, si dhe çdo referencë tjetër të cituar në këtë vendim.

Gara në tender fliste qartë. Kompania "EVOLVE WEB STUDIO" garoi me 33 milionë lekë, ndërsa "INSTANT.AL" me 33.7 milionë lekë. Në krahun tjetër, bashkimi i operatorëve "INTELISOFT & WOW DIGITAL" paraqiti ofertën më të shtrenjtë me 40.8 milionë lekë.

II.3. Në datën 11.10.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"NOAL" SHPK	0	leke	skualifikuar
2	"Evolve Web Studio" SHPK	33.000.000	leke	skualifikuar
3	"INSTANT.AL" SHPK	33.700.000	leke	skualifikuar
4	BOE "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK"	40.823.564	leke	kualifikuar

Megjithatë, përfundimi sfidoi çdo logjikë ekonomike. Oferta më e kripur doli fituese, falë një operacioni të quditshëm pikëzimi në kriteret teknike.

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditis Latinopoulou

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Shërr mes të rinjve në Sarandë/ Dalin PAMJET nga vendi i ngjarjes, njëri prej autorëve tenton t'i ngulë thikën në qafë...

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow.

Ndërsa komisioni zyrtar përbëhej nga tre anëtarë të caktuar që përbëhej nga Daniela Alimemeti, Redion Lila dhe Fatjona Sulaj, KPP thotë se në sistemin elektronik shfaqet papritur përdoruesi "Jonakqz Josifi". Pikërisht gjatë fazës së rivlerësimit, në mënyrë të rrufereshë, dy operatorët me çmimet më të lira u shënuan me 0 pikë në të pesë kriteret teknike. Përkundërt tyre, kompanisë me ofertën më të shtrenjtë iu falën pikët maksimale. Pra një skandal në dritë të diellit, zero në njërin krah, maksimumi në krahun tjetër.

Prapa emrit të përfituesit të këtij operacioni qëndron biznesmeni Gëzim Hoxha përmes kompanisë "INTELISOFT". Hoxha është vëllai i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, si dhe pronar i kompanisë "FIRST", e cila përmendet në shumë fashikuj të dosjes së AKSHI-t si një nga përfitueset kryesore të tenderëve publikë.

Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve	
12. Ortakët	Gëzim Hoxha
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 5.000.000,00 Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
<i>*Të përfaqësuarit. (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	

2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.4 Komente (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: INTELISOFT E-Mail: info@first.al Telefon: 0682055559
15. Statusi:	Aktiv

Të dhënat e hetimit zbulojnë se ai ka përfituar dhjetëra miliona euro nga arka e shtetit, ku vetëm në një rast ka deklaruar përfitimin e rreth 60 milionë eurove nga AKSHI, para që më pas janë transferuar te subjekte të lidhura, përfshirë bashkëpunëtorë si Ermal Beqiri.

Emri i Gëzim Hoxhës shfaqet po ashtu në aferën e "Durana Tech Park", ku një grup kompanish të lidhura dyshohet se ndërtuan një skemë për transferimin e aktivitetit në parqe teknologjike me qëllim shmangien e taksave përmes subjekteve të reja, por me të njëjtët përfitues realë.



Kështu, skema merr formë të plotë, një zyrtarë e lartë jashtë komisionit hyn në mënyrë të paligjshme në sistem, asgjëson rivalët me zero pikë dhe ngre në majë kompaninë me çmimin më të lartë, të lidhur me emrat më të

përfolur të tenderëve të teknologjisë.

Reagimi i operatorëve të dëmtuar e çoi çështjen në KPP, i cili e rrëzoi si të paligjshëm klasifikimin e KQZ-së. Por në vend që të reflektonte, KQZ ndërmori një betejë për të mbrojtur këtë rezultat, duke u arsyetuar se gjithçka ishte e automatizuar nga sistemi. KPP sërish e refuzoi sërish këtë pretendim, duke e detyruar institucionin e zgjedhjeve të kthehet prapa.

Mbrojtja e KQZ-së mori nuanca edhe më agresive kur nisi paralelisht kërkesa për penalizimin e operatorit "INSTANT.AL", me pretendimin se kishte paraqitur dokumente të rreme. Mirëpo, Agjencia e Prokurimit Publik nuk e ka gëlltitur këtë version, duke bllokuar goditjen dhe duke kërkuar verifikime zyrtare direkte në burim.

Kjo ngjarje nxjerr në dritë një paradoks të rëndë. KQZ, institucioni që ka për detyrë të garantojë besueshmërinë, ndershmërinë dhe votën e lirë të qytetarëve, kapet në flagrancë duke lejuar kapërcimin e ligjit në administrimin e parave publike.

Në këtë histori, po aq përgjegjësi kanë edhe drejtuesit e KQZ-së, përfshirë kryekomisionerin Ilirjan Celibashi. Kur Sekretarja e Përgjithshme futet pa mandat në sistemin e prokurimit dhe dikton fituesin, kjo nuk është më një rrjedhje teknike, me të cilën mund të kalosh radhën. Është një shkelje e rëndë ligjore që kërkon llogaridhënie të menjëhershme se kush e autorizoi ndërhyrjen e saj dhe në emër të cilit interes u orientuan pikët.

Historia bëhet edhe më shqetësuese kur në fund të kësaj procedure shfaqen emra dhe kompani të përmendura edhe në skandalin e AKSHI-t i cili është nën hetim nga SPAK./VNA

tenderi i komisionit qendror të zgjedhjeve

Galeria fotografike ()



12. Ortakët	Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve	
12.1. Vlera e kapitalit	Gëzim Hodha	
12.2. Numri i pjesëve	Para: 5 000 000.00	Natyre:
12.3. Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00	
*Te përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuantë kontrolet në bashkëpronësi)	100,00	

2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.4. Komente (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: INTELISOFT E-Mail: info@first.al Telefon: 0682055559
15. Statusi:	Aktiv

II.3. Në datën 11.10.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	" NOAL " SHPK	0 leke	skualifikuar
2	" Evolve Web Studio " SHPK	33.000.000 leke	skualifikuar

3	"INSTANT.AL" SHPK	33.700.000 leke	skualifikuar
4	BOE "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK"	40.823.564 leke	kualifikuar

eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në vlerësimin e tij, të pakuptimtë. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) Komisioni konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi përmbetet nga 3 (tre) anëtarë dhe konkretisht zj.

4

Daniela Allimemeti, z. Rodion Lila dhe zj. Fajona Salaj, të cilët kanë rishikuar me pikë përkatësisht ofertën e operatorit ekonomik ofrues "INSTANT.AL" SHPK, ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK" dhe ofertën e operatorit ekonomik "Evolve Web Studio" SHPK sipas vlerësimit të bërë nga po ky komision në datën 16.12.2025, referuar shkresës nr. 48/4 prot. datë 26.01.2026 "Përvojë vendimi të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave" protokolliuar me tërësi me numër protokoll nr. 107/3 prot. datë 27.01.2026, ndjekësit që konstatohet se ofertat e sipërpërmendura janë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.